



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, Datë 08.04.2014

PËR

MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRUAR
NDËRSEKTORIAL PËR ZONËN EKONOMIKE TIRANË-DURRËS

Në mbështetje të neneve 8, 29, 33, pika 3, 35, pika 1, dhe neneve 36-39 të Ligjit nr.10 119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, Kreut V “Planifikimi i integruar” të VKM-së nr. 481, datë 22.06.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Instrumenteve të Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, si dhe në vijim të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 2, datë 18.10.2013 “Për fillimin e procedurave për hartimin e planit të integruar të përgjithshëm për zonën ekonomike Tiranë-Durrës”, me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e nismës për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës.
2. Fillimin e procedurës për ngritjen e grupit të punës me ekspertë me qëllim hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës.
3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të drejtojnë punën për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial dhe të kryejnë bashkërendimin, këshillimin dhe organizimin e dëgjësive publike me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara.
4. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:



- a. Studimi që përcakton faktet dhe problemet, të cilat shprehin nevojën për Planin e Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës;
 - b. Plani i veprimeve për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës;
 - c. Buxheti për hartimin e këtij plani;
 - d. Kufijtë dhe përcaktimi në hartë i zonës që do të studiohet.
5. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE EKKT

EGLANTINA GJERMENI

Eglantina Gjermeni

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Adelina Greca

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

